



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:070968  
Datë: 11.04.2024  
Numri i dokumentit: 05563304

K.DH.SH.II.nr.47/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë Bulevardi “Bill Clinton” nr.5, ndaj debitorit Koperativa Bujqësore “Iliria”, me seli në Budisalc Komuna Klinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Cenë Gashi nga Klina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2613/22, të datës 10.11.2023, me datë 11.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë Bulevardi “Bill Clinton” nr.5, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2613/22, të datës 10.11.2023, Vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2613/22, të datës 10.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Koperativa Bujqësore “Iliria”, me seli në Budisalc Komuna Klinë, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.1637/18 dt.26.11.2018, lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku, për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit ka paraqitur debitori, me arsyetimin se e kundërshton atë ankesë sipas te gjitha bazave juridike, si te pabazuar, propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta refuzoj te njejtën si te pabazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Dhoma e shkalles se dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 te Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, me datën 26.11.2018, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Koperativa Bujqësore “Iliria”, me seli ne Budisalc Komuna Klinë, në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, si dokument i besueshëm DPE -9009993. Përmbartuesi Privat Blerim Baloku, sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr.1637/18 dt.26.11.2018, me të cilin e ka detyruar debitorin qe kreditorit, ne emër te borxhit për konsum te energjisë elektrike, ne afat prej 7 ditësh ti paguaj shumen prej 689.44€, për periudhën prej 19.07.2016 deri me datën 12.10.2018, me kamatë prej 8% nga dita e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive te borxhit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 20.12.2018, me pretendimin se debitori ka vetëm një shpenzues –dritë për ndriçim te rojës se objekteve atëherë si është e mundur qe me një elektrik te krijohet një borxh i tillë. Debitori nuk mban përgjegjësi dhe juridikisht nuk është përgjegjës për borxhin e krijuar nga njehsorët elektrik te ndërruar nga kreditori shton se ne fund te ekstraktit është shënuar Rikthim i humbjeve ne emër te KEDS, dhe se për çfarë humbjesh nuk dihet, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta anuloj, propozimi i kreditorit te refuzohet ndërsa ne emër te shpenzimeve te detyrohet kreditorit te paguaj shumen prej 160 euro sipas OAK.

Ndaj prapësimit te debitorit, kreditori me datën 31.12.2018 ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se pretendimet e debitori nuk qëndrojnë dhe se leximi i njehsorëve bëhet nga aparati dixhital propozimi për përmbartim është pe periudhën prej 19.07.2016 deri me datën 12.10.2018, debitori ka bere disa pagesa si me datën 06.03.2017, pastaj me datën 28.07.2016 ashtu qe me këto pagesa është ndërprerë afati i parashkrimit i cili llogaritet veç e veç për secilën faturë. Kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar dhe ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës përmbartimore, andaj propozon qe gjykata ta lë fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2613/22 dt.10.11.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor, duke vendosur kështu si ne dispozitiv te aktvendimit. Ne arsyetim te këtij aktvendimi gjykata e shkalles se parë ka theksuar se duke vepruar sipas sugjerimeve te Gjykatës e Apelit ka mbajtur seancën dëgjimore dhe pas shqyrtimit te pretendimeve te palëve dhe provave ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar ndërsa

urdhri përbarimor duhet të anulohet. Gjykata i referohet nenit 29 par.1, 1.2 të LPP, nenit 37 të LPP, duke vlerësuar se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përbarim. Gjykata gjënë se kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit në lartësi prej 689.44 euro për periudhën prej 19.07.2016 deri me 12.10.2018, ndërsa nga ekstrakti mbi të cilin mbështet propozimi rezulton se debitori me datën 19.07.2016 është faturuar në shumen prej 597.38 euro nën përshkrimin *Correction* mirëpo në ekstrakt nuk është treguar se për çfarë përmirësimi bëhet fjalë dhe nëse kjo shumë e përmirësuar ka të bëjë me shërbimet e pranuar në emër të konsumit të energjisë elektrike, kjo rrethanë nuk është sqaruar as nga përfaqësuesi i kreditorit në seancën dëgjimore i cili ka deklaruar se kjo shumë është faturuar në emër të energjisë elektrike por që mund të jetë detyrim i bartur nga muajt paraprak për shkak të ndërrimit të njehsorëve elektrik. Pra gjykata gjene se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi përmban të meta në raport me objektin sepse nuk dihet se faturimi është bërë në emër të shfrytëzimit të shërbimeve me energji elektrike dhe nëse ky detyrim që është kërkuar për përmbushje në lartësi prej 689.44 euro i takon dhe është krijuar përgjatë periudhës kohore prej 19.07.2016 deri me 12.10.2018 për të cilin kërkohet përmbushja sipas propozimit për përbarim, ashtu që konform nenit 71.1 dhe 73, dhe nenit 13 par.1.2 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e shkalles së dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore, Aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë përfshirë as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së dhe nuk as shkelje lidhur me zbatimin e të drejtës materiale për të cilat Gjykata e shkalles së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Po ashtu aktvendimi i atakuar nga gjykata e shkallës së parë është marrë pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të cilat kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në ligj.

Në lidhje me këtë gjykatë vlerëson se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi gjegjësisht ekstrakti i verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit me nr. DPE -9009993, nuk plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sepse nuk është në pajtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 29 par.1 nënpar.1.2 të LPP. Sipas propozimit për përbarim rezulton se kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori për periudhën prej 19.07.2016 deri me datën 12.10.2018 me shumë prej 689.44 euro ndërsa sipas ekstraktit mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi rezulton se debitori me datën 19.07.2016 është ngarkuar nga ana e kreditorit për shumen prej 597.38 euro me përshkrimin *Correction* ose përmirësim i cili nga ana e kreditorit as në seancën dëgjimore nuk është qartësuar dhe sqaruar se për çfarë përmirësimi është fjala, se kjo shumë a ka të bëjë me periudhën kohore të precizuar nga kreditori në propozimin për përbarim dhe me shfrytëzim të energjisë elektrike apo kjo shumë është borxh i akumuluar në periudhat e mëhershme para datës 19.07.2016. Andaj bazuar nga këto të lartcekura edhe gjykata e shkalles së dytë vlerëson se në rastin konkret Ekstrakti i lëshuar nga kreditor ashtu siç është nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së dhe nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 21 të njëjtit ligj sepse detyrimi i kërkuar nga kreditori ndaj debitorit është i paqartë, marrë

për bazë shumen me datën 19.07.2016 dhe pagesat e bëra kohë pas kohe ne raport me totalin e kërkuar.

Marrë parasysh këtë gjendje faktike, kjo gjykatë vlerëson përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë dhe merr parasysh nenin 43 par.4 te LPP i cili parasheh qe “*Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*”.

Po ashtu kjo gjykatë i ka analizuar pretendimet e kreditorit por konsideron se nuk qëndrojnë, te njëjtat nuk janë relevante për një vendosje ndryshe, sepse ne rastin konkret kreditori nuk ka ofruar prova ne mbështetje tyre, ashtu qe vendosi qe ti refuzoj si te pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 par.1pika (b) te LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr. 47/24, me datë 11.04.2024

Gjyqtari  
Ramush Bardiqi